



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 6
Prishtinë, më 11maj 2011, në orën 11:15
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P r o c e s v e r b a l

Nga takimi i Komisionit me delegacionin e Parlamentit të Holandës

Delegacioni i Parlamentit të Holandës ishte në këtë përbërje: Gerda Verburg - kryetare e Komisionit Parlamentar për Çështje Evropiane, Harry van Bommel - zëvendëskryetar, Louis Bontes, Henk Jan Ormel, Han ten Broeke, Gerard Schouw, z. Pierre Heijnen - anëtarë, Joop Nijssen - asistent në Komision dhe Robert Bosch – ambasador, Emma Kay - zëvendësshef i Mimisionit, Carel Brands - këshilltar i lartë për politikë në Ambasadë.

Në takim nga Komisioni morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Shaip Muja, Skender Hyseni, Sabri Hamiti, Donika Kadaj-Bujupi dhe Amir Ahmeti.

Mungoi: Petar Miletqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati – ZPRK, Blerim Vela – OSBE, Mimoza Gojani - Ambasada Britanike, Mimika Dobrosi – KCSF dhe Lejla Selimi - OSBE.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Elfete Alshiqi - praktikante.

Takimin e kryesoi: Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

R e n d i i d i t ë s:

Takimi i Komisionit me delegacionin e Parlamentit të Holandës

Albin Kurti - Në emër të Komisionit e përshëndeti dhe i dëshiroi mirëseardhje delegacionit të Komisionit për Çështje Evropiane të Parlamentit të Holandës. Këtë takim e konsideroi shumë të frytshëm me synim të thellimit të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve. I falënderoi delegacionin, për vizitën e bërë dhe shtetin e Holandës, për kontributin e dhënë për Kosovën, si para, ashtu edhe pas luftës, në mënyra të ndryshme.

Republika e Kosovës tani është duke punuar të shtohet numri njohjeve. Kosova ka sfida dhe probleme në mungesë të zhvillimit ekonomik, në njërën anë, dhe në anën tjetër për mungesën e integritetit territorial, të kontrollit të kufijve, që vjen drejtpërdrejt nga obstrukcionet, që i bën Serbia

në Kosovë, nëpërmjet strukturave ilegale. Kjo situatë e ndërlikuar, shtoi ai, kulmon edhe me protektoratin ndërkombëtar, që nuk i jep llogari popullit dhe institucioneve të Kosovës dhe ka fuqi ekzekutive mbi institucionet Kosovën. Ka ardhur koha që Kosova, përveç se e pavarur, të bëhet edhe sovranë dhe të zhvillohet ekonomikisht, që të jetë plotësisht e denjë për avancim të përshpejtuar në integrimet evropiane.

Gerda Verburg - kryetare e Komisionit për Çështje Evropiane – Falënderoi për pritjen që i është bërë nga Komisioni për Punë të Jashtme. Këtë takim e konsideroi me interes të përbashkët, për të diskutuar me njëri-tjetrin, si pjesë përbërëse e kuvendeve, për të ardhmen e përbashkët, në veçanti për të ardhmen e Kosovës.

Gerard Schouw – Tha se është pjesëtarë i Partisë Liberal Demokratike në Holandë, që ka vizion për një Evropë të fuqishme. Kërkoi të njoftohej, kur dhe në çfarë kushtesh Evropa, përkatësisht EULEX-i, mund ta drejtojë Kosovën për udhëtime në mënyrë të pavarur dhe çfarë veprimesh duhet të ndërmerret Kosova për t'i bindur edhe pesë shtetet e tjera të BE-së, që nuk janë në favor të njohjes së Kosovës.

Albin Kurti - Sa i përket EULEX-it, tha se, ai e definon veten si operacion të menaxhimit të krizave dhe sundimin e ligjit e parasheh brenda paradigmes të stabilitetit dhe nuk e lidh atë me drejtësinë për qytetarët dhe me të drejtat e qytetarëve. Edhe pas dy vjet e gjysmë, që EULEX-i është këtu, nuk mund të themi, se kemi rezultate, që janë pritur nga dashamirët. Ne do të dëshironim ta shihnim një zhvendosje të paradigmes së stabilitetit afatshkurtër, në zhvillim të qëndrueshëm. Kosova është një vend me deficit të tmerrshëm tregtar. Gjithashtu as nga UNMIK-u, as nga EULEX-i, nuk janë të adresuara krimet e luftës nga Serbia, as shkatërrimet e bëra në Kosovë. Po ashtu nuk ka përparim në luftimin e korrupsionit, sepse ai është bërë vetëm në nivelet e ulëta, ngase stabiliteti ka qenë ai që e ka udhëhequr Misionin e EULEX-it. Mendoj se kemi nevojë për një ridefinim të Misionit të BE-së në Kosovë, për ta zhvilluar dhe për ta përgatitur Kosovën për integritet evropian.

Skender Hyseni - Mosnjohja nga pesë vendet e BE-së është duke ndikuar në mënyrë shumë negative në raportin kontraktual ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe atyre të BE-së. Kosova nuk mund të bëjë më tepër për ta fituar njohjen edhe nga këto pesë vende të BE-së. Kemi qenë në kontakt të përhershëm me ato vende, kemi bërë përpjekje të vazhdueshme, mirëpo mundësitë që i ka Kosova për t'i bindur ato janë të pakta. Apeloj tek parlamentarët holandezë t'i shfrytëzojnë gjithë mekanizmat e mundshëm për të bërë presion miqësor te këto pesë vende, që nuk e kanë njohur Kosovën, ta njohin pavarësinë e saj. Ne kërkojmë qartësi të plotë të institucioneve të BE-së ndaj pavarësisë së Kosovës.

Louis Bontes - Jam pjesëtarë i Partisë për Liri, që është partia e tretë në Holandë dhe është mjaft kritike sa i përket BE-së. Ne nuk duam një supershtet evropian, ne nuk duam zgjerim të mëtejshëm të BE-së, as me Islandën, as me Kroacinë, as me Turqinë e as me Kosovën dhe jemi kundër liberalizimit të vizave. Duke i pasur parasysh ankesat ndaj EULEX-it, që i dëgjova, pyes: *Ç'do të ndodhte me Kosovën, nëse ne do ta ndalonim Misionin e EULEX-it, nëse nuk do ta merrni liberalizimin e vizave dhe nëse nuk do ta keni ndonjë perspektivë?*

Henk Jan Ormel - pjesëtar i Partisë Kristian Demokrate - Kam votuar në favor të njohjes së pavarësisë së Kosovës. Ne besojmë në të ardhmen evropiane të Ballkanit Perëndimor, por duhet të përmbushen kriteret e Kopenhagës. Sa i përket njohjes së Kosovës e shoh si një vështirësi të madhe për Bashkimin Evropian.

Hydajet Hyseni – E falënderoj Parlamentin e Holandës për bashkëpunimin dhe shtetin e Holandës për ndihmën e dhënë Kosovës. Mënyra më e mirë për ta shprehur mirënjohjen për ndihmën nga miqtë ndërkombëtarë është ndërtimi i një Kosove çfarë i duhet vendit dhe miqve tanë. Kosova ka qenë një shembull i ndërtimit dhe i ruajtjes së paqes, falë autoriteteve vendore dhe misionëve ndërkombëtarë. Megjithatë kemi edhe vërejtje, që janë në funksion të përmbylljes së fazës së transicionit, në të mirën e të dy palëve. Kosova e ka 1/3 e popullsisë jashtë, me decenie ka prani ndërkombëtare brenda dhe vazhdon të mbetet e izoluar në krahasim me vendet që kanë qenë burim i konflikteve dhe i destabilizimit. Ky bllokim i lëvizjeve nuk është produktiv, sepse kryesisht i dëmton njerëzit e ndershëm, përderisa ata të pandershmit gjejnë mënyra për të depërtuar në të gjitha vendet e Evropës. Ndihma e Holandës është e domosdoshme në aspektin e njohjeve, duke pasur parasysh faktin se Kosova është *sui generis*, ku ka pasur gjenocid dhe shpërbërje të shtetit të Jugosllavisë, për dallim nga shtetet e tjera, që brenda vetes kanë probleme të pazgjidhura. Kosova ka nevojë për ndihmë në procesin e integritetit, që praktikisht dhe legalisht të funksionojë si pjesë e Evropës.

Harry van Bommel - Nga fakti që pesë shtete të BE-së nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe sipas të gjitha gjasave nuk do ta njohin, Kosova duhet ta ketë një rrugë alternative për të ardhmen dhe kjo rrugë mund të mos jetë Bashkimi Evropian. Kjo rrugë mund të jetë integriteti me Shqipërinë ose mund të jetë ndarja e Kosovës. Kjo nuk na takon neve, kjo nuk i takon BE-së, kjo i takon popullit dhe përfaqësuesve të popullit të Kosovës. A është paraparë apo a do të parashihet ndonjë alternativë për Kosovën, meqë rrugëtimi për Bashkimin Evropian mund të jetë i mbyllur?

Pierre Heijnen - A do të ketë bashkëpunim me Tribunalin Ndërkombëtarë për Krimet e Luftës, nëse njerëzit do të vijnë këtu dhe do të kërkojnë pohimet apo pretendimet tuaja për krimet e luftës?

Donika Kadaj-Bujupi - Sa i përket bashkëpunimit me Tribunalin e Hagës Kosova e ka dhënë ndihmën e saj qysh në vitin 2005. Kosova në këtë drejtim dallon nga Serbia, që e ka fituar liberalizimin e vizave, edhe pse po vazhdon t'i fshehë kriminelët e luftës dhe si agresore, është përgjegjëse për të gjitha luftërat në ish-Jugosllavi. Kosova e ka dhënë provimin e saj. Kjo dihet nga të gjithë partnerët ndërkombëtarë, kur në vitin 2005, kryeministri i Kosovës vullnetarisht dha dorëheqje dhe brenda 24 orëve u dorëzua në Hagë.

Sabri Hamiti - Duke iu referuar diskutimit të z. Bommel, tha se në Kosovë ekziston një konsensus nacional në politikë, që Kosova të shkojë në integritet evropian, që i nënkupton integritet euroatlantike. Pavarësia e Kosovës, që tani e kemi, është kompromis nacional i shqiptarëve. Pra nuk është insistuar në bashkimin e të gjitha trojeve të popullit shqiptar, por në krijimin e një komoditeti të strukturës etnike, çfarë është në Kosovë, që dominohet me më se 90% të shqiptarëve. Kjo është zgjidhja dhe është menduar që këto integritete të bëhen me Bashkimin Evropian, me politika të përbashkëta rajonale, shqiptare dhe evropiane. Sa i përket ndarjes së Kosovës, ajo nuk vjen në konsiderim, sepse prodhon konflikte të reja, ku shqiptarët nuk humbin asgjë, vetëm se ripreken etnikisht kufijtë e Ballkanit. Prandaj është gabim i madh nëse izolohet Kosova. Me izolimin e Kosovës do ta detyroni Kosovën, që kolektivisht të marrë pasaporta ose të Shqipërisë, ose të Serbisë. Këtë e lejon ligji i shtetësisë së Kosovës dhe kështu do të krijojmë konfuzion total. Liberalizimi i vizave duhet të shikohet në mënyrë më komplekse. Ndarje të Kosovës nuk ka. Bashkimi me Shqipërinë është bashkim në perspektivë evropiane, sepse ne e kemi shpallur Kosovën e pavarur dhe detyra jonë parësore është ta bëjmë Kosovën sovranë. Holanda është mirë e njoftuar me ndodhitë në Bosnjë. Është harruar kreatori i masakrës së Srebrenicës dhe i është dhënë liberalizimi i vizave Serbisë. Në një mënyrë drejtësi nuk ka, ata që kanë bërë gjenocid në Kosovë kanë liberalizim të vizave, ndërsa shqiptarët e Kosovës, që e kanë provuar gjenocidin, nuk kanë liberalizim të vizave.

Albin Kurti - Në katër luftërat në ish-Jugosllavi janë vrarë afër 200 mijë joserbë. Nëse një ushtar, polic ose paramilitar serb i ka vrarë pesë njerëz, duke i lënë anash plagosjet, torturat, dhunimet, kjo i bie që janë 40 mijë vrasës serikë, që shëtisin të lirë në Serbi. Tani e kanë fituar edhe liberalizimin e vizave që të shëtisin të lirë në Evropë, dhe asnjë promil i tyre nuk është akuzuar as dënuar. Ne kemi bashkëpunuar gjithmonë me organizmat ndërkombëtarë të drejtësisë, posaçërisht me Tribunalin e Hagës dhe nëse diku, ndonjë shqiptar, ka bërë ndonjë krim, këtë nuk e ka bërë në emër të ndonjë organizate, nuk e ka bërë në emër të ndonjë plani të paramenduar, siç ka qenë rasti me Serbinë. Kjo ka ndodhur, eventualisht atëherë, kur Serbia ka kryer masakra dhe ekzekutime masive të shqiptarëve.

Gerda Verburg - Falënderoi për mundësinë e takimit dhe për diskutimet e drejtpërdrejta dhe të sinqerta të anëtarëve të Komisionit.

Albin Kurti - E falënderoi delegacionin për vizitën dhe për kontributin e tij. Kërkoj nga delegacioni të shqyrtohet propozimi i tij, që Serbia të kushtëzohet për marrjen e statusit të vendit kandidat të BE-së me: tërheqjen e strukturave ilegale në Kosovë, me kërkim faljeje dhe me dëmshpërblim për shkatërrimet, që i ka bërë në të kaluarën. Ai tha se nuk mund të kemi paqe pa drejtësi dhe njëkohësisht nuk do të kemi drejtësi pa e marrë në konsideratë historinë, që e mbajnë mend të gjithë.

Takimi përfundoi në orën 12:10.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti